



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë; E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); Web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr.188/7, Prot.

Tiranë, më 30.06.2018

## V E N D I M

**Nr.76, Datë 30.06.2018**

**Për Auditimin e ushtruar në Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA "Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare" për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datën 31.12.2017.**

Nga auditimi i Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA (UKKO), mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare, për periudhën objekt auditimi, rezultoi që përsa ju përket realizimit të treguesve të performancës (realizimi i të ardhurave), duke vlerësuar nivelin e faturimeve, normën e arkëtimit, humbjet në rrjet, mbulimin me punonjës/lidhje, nivelin e debitorëve, në përgjithësi UKKO është paraqitur me tregues pozitivë, por në krahasim me periudhat e mëparshme ka një përkeqësim të lehtë të tyre. Përsa i përket menaxhimit të shpenzimeve, kryerjes së tyre në përputhje me kuadrin rregullator të fushës, kanë rezultuar mangësi dhe shkelje në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave, gjë e cila është shoqëruar me dëm ekonomik në vlerën 11,067,965 lekë. Si rezultat i mos pasqyrimit të drejtë të veprimeve kontabël, mos likuidimit të detyrimeve të lindura nga marrëveshjet e kredive, pasqyrat financiare nuk pasqyrojnë drejtë gjendjen financiare të shoqërisë. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në zbatimin e strukturës organizative dhe nivelit të pagave, si dhe në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

## VENDOSA

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për vlerësimin e aktivitetit, transaksioneve financiare dhe informacioneve, në aspektet materiale, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë subjekti”, të ushtruar në Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, sipas Programit të Auditimit nr. 188/1 datë 19.02.2018 ndryshuar me Shkresën nr. 188/2, datë 13.03.2018, nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, për veprimtarinë nga data 01.01.2015 deri më datën 31.12.2017, me afat auditimi nga 19.02.2018-30.04.2018.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

### A. MASA ORGANIZATIVE:

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në auditimin e mëparshëm të ushtruar në Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, për periudhën e aktivitetit 01.01.2012-30.06.2014, ka lënë për zbatim 25 “Masa organizative”, 8 “Masa zhdëmtim dëmi”, 1 “Masë administrative” dhe 10 “Masa disiplinore”. Për shqyrtimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, Këshilli Mbikëqyrës i Ujësjellës Kanalizimeve Korçë SHA ka marrë Vendimin nr. 1, datë 23.01.2015, Vendimin nr. 2, datë 23.01.2013, Vendimin nr. 3, datë 23.01.2015, ku në përfundim të këtij auditimi niveli i zbatueshmërisë paraqitet si më poshtë:

Rekomandime	Propozuar	Statusi i rekomandimeve				Realizimi %
		Realizuar	Në proces	Pjesërisht	Nuk pranohet	
Masa organizative	25	23	-	1	1	92
Masa zhdëmtimi	8	6	-	-	2	75
Masa Administrative	1	1	-	-	-	100
Masa disiplinore	10	9	-	-	1	90
<b>Shuma:</b>	<b>44</b>	<b>39</b>	<b>-</b>	<b>1</b>	<b>4</b>	<b>88</b>

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e detyrave të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, ka rezultuar se nga ana e Këshillit të Mbikëqyrës të Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, nuk janë zbatuar rekomandimet e mëposhtme, për të cilat **ri-kërkoj** shqyrtimin dhe zbatimin e tyre:

*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 18-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1. Rekomandimi:** Këshilli i Administrimit të marrë masa, për rishqyrtimin dhe zbatimin rekomandimeve të mëposhtme:

**1.1.1.** Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **2,503,996 lekë**, përfituar më tepër, si shpërblim për kryerjen e detyrës së kryetarit, anëtarit dhe sekretarit të Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 6, germa “c”, udhëzimit të METE nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, pika 5, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, sipas tabelës së mëposhtme:

### Vlera e përfituar më tepër sipas personave

Nr	Këshilli Mbikëqyrës	Pozicioni	Shuma lekë
1	S.F.	Kryetar	444,436
2	J.S.	Anëtar	467,640
3	P.P.	Anëtar	467,640
4	A.Q.	Anëtar	467,640
5	Gj.G.	Anëtar	467,640
6	E.P.	Sekretar	189,000
7	<b>Totali</b>		<b>2,503,996</b>

**1.1.2.** Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, Drejtorit të Përgjithshëm, të merret në analizë dhe shqyrtim moszbatimi nga ana e administratës i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36, përsa i përket administrimit të lëvizjes së mjeteve e shpenzimeve të karburantit, si dhe të administrimit të shpenzimeve për karburantin që përdoret për ngrohje, për demin ekonomik në vlerën **8,177,154 lekë** si dhe të dalë përgjegjësia lidhur me krijimin e këtij dëmi.

**1.1.3.** Mbështetur në nenet 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar dhe në zbatim të nenit 17, të Kontratës Kolektive të Punës, ti rekomandojmë Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore: “Shkarkim nga detyra” për z. P.T., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizimeve Korçë SHA.

**2. Gjetje nga auditimi:** Këshilli i Administrimit, është emëruar me Vendimi nr. 1, datë 25.05.2016 të Asamblesë së Përgjithshme. Nga auditimi u konstatua se, anëtarët e Këshillit të Administrimit, kanë lidhur kontratën e performancës me Ujësjellës Kanalizimeve Korçë SHA. Kjo kontratë është lidhur më datë 15.02.2018, përtej afateve të përcaktuara, si dhe nuk është e miratuar nga ministria e linjës.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 25-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**2.1.Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, të marrë masa të menjëhershme për miratimin e Kontratës së lidhur midis Këshillit Mbikëqyrës dhe Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, nga ministria e linjës.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Me vendimin nr. 4, datë 12.02.2015, për miratimin e masës të trajtimit financiar për punonjësit e UKKO që dërgohen me shërbim jashtë vendit, Këshilli Mbikëqyrës ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pasi për Drejtorin e Përgjithshëm është miratuar akomodimi në hotel deri në 5 vje, ku sipas VKM-së Drejtorët e Përgjithshëm bëjnë pjesë në kategorinë nr. 6, të cilët akomodohen në hotele deri në 4 vje. E njëjta problematikë vlen edhe për punonjësit e nivelit të lartë, të mesëm dhe të ulët të menaxhimit dhe punonjësit mbështetës, për të cilët është miratuar hotel deri në 4 vje, ku sipas VKM-së, bëjnë pjesë në kategorinë nr. 7 dhe nr. 8, për të cilat lejohen hotele deri në 3 vje.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 25-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**3.1. Rekomandimi:** Këshilli Administrimit, të marrë masa të menjëhershme për ndryshimin e vendimit nr. 4, datë 12.02.2015, të Këshillit Mbikëqyrës “Për miratimin e masës të trajtimit

financiar për punonjësit e UKKO që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe përcaktimin e mënyrës dhe masës së trajtimit në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se në hartimin e programeve ekonomiko-financiare, nuk është bërë një analizë e thellë dhe e detajuar e të gjithë treguesve dhe të dhënave kontabël, me qëllim marrjen e vendimeve sa më reale për zhvillimin ekonomik dhe financiar të shoqërisë. Nuk është bërë një analizë e pasqyrave financiare, pasi ka rezultuar se nuk janë përlogaritur në mënyrën e duhur disa transaksione, të cilat kanë të bëjnë me përlogaritje të amortizimit, huamarrjen dhe detyrimet për shlyerjen e principalit dhe interesave, gjendjen e cash flow-t, detyrimet që të tretë kanë ndaj UKKO, sipas marrëveshjeve të nënshkruara, fakte të cilat pas përlogaritjes kanë sjellë ndryshim të rezultatit financiar (nga fitim në humbje) dhe për rrjedhojë ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në Programet ekonomiko-financiare dhe vendimmarrjet për të ardhmen e shoqërisë.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 29-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**4.1. Rekomandimi:** Ujësjetës Kanalizime Korçë SHA të marrë masa, që gjatë procesit të hartimit të programeve ekonomiko-financiare, të kryejë analiza të thella dhe të detajuara në lidhje me; detyrimet kundrejt të tretëve, e në mënyrë të veçantë ato që lindin si rezultat i marrëveshjeve të kredive, të drejtat e shoqërisë, duke analizuar mundësitë reale të vjeljes së tyre, analizë dhe përlogaritje të provizioneve, analizë dhe evidentim të saktë të aktiveve të shoqërisë; vlerësim të veprimeve dhe transaksioneve financiare, duke bërë analizë kosto-përfitim, etj, me qëllim hartimin e programeve të zhvillimit sa më real dhe në dobi të shoqërisë.

**Në vijim**

**5. Gjetje nga auditimi:** Shpenzimet për energjinë elektrike, në vitin 2016 kanë rezultuar me tejkalim ndaj parashikimit në vlerën 3,040,000 lekë, ose në masën 9% dhe në vitin 2017 me tejkalim në masën 50 % kundrejt parashikimit, ose në vlerën 15,062,573 lekë më shumë. Kjo luhatje e lartë ka ardhur si rezultat i mos kryerjes në mënyrë sistematike të balancimit të energjisë elektrike, nga ana e OSHEE dhe UKKO, për energjinë e prodhuar nga Impianti Fotovoltaik i instaluar tek ITUN. Gjithashtu, ka një rritje të shpenzimeve për energjinë elektrike nga viti në vit. Në vitin 2015 si rezultat i instalimit të Impiantit Fotovoltaik shpenzimet për energjinë elektrike u ulën me 48 % kundrejt parashikimit, ndërsa në dy vitet në vazhdim ka rritje të tyre kundrejt parashikimit dhe shpenzimeve faktike të vitit 2015.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 29-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**5.1.Rekomandimi:** Administratori i Ujësjetës Kanalizime Korçë SHA të nxjerrë përgjegjësitë për mos menaxhimin në mënyrën e duhur, të energjisë elektrike të prodhuar nga Impianti Fotovoltaik, si dhe të marrë masa të menjëhershme për miradministrimin e energjisë së prodhuar nga ky impiant, duke rakorduar dhe bashkëpunuar në vazhdimësi me KESH. SHA

**Menjëherë dhe në vijim**

**6. Gjetje nga auditimi:** Gjatë periudhës objekt auditimi, kryesisht në vitet 2016 dhe 2017, si rezultat i reformës administrative dhe bashkimit të UKKO (qytet) me UKKO (fshat), ka patur një rritje të numrit të abonentëve, rritje e cila është shoqëruar edhe më rritjen e numrit të abonentëve

debitorë. Në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015 numri i tyre është rritur me 662 abonentë, ndërsa në vitin 2017 në krahasim me vitin 2016 numri i tyre është rritur me 1.954 abonentë.  
*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 29-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**6.1. Rekomandimi:** Administratori i Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, të marrë masa të menjëhershme për angazhimin e strukturave të UKKO, për evidentimin, ndjekjen dhe minimizimin e nivelit të abonentëve debitorë.

**Në vijim**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga këqyrja e kategorizimeve sipas vendimit nr. 2, datë 22.11.2011 “Për përcaktimin e strukturës dhe nivelit të pagave”, ka rezultuar se:

- përsa i përket kategorisë Inxhinier, është përcaktuar pozicioni “Inxhinier i ri” dhe “Inxhinier me përvojë”, ndërkohë që në listën e punonjësve për vitin 2015, pozicionet e inxhinierëve janë sipas profilit të tyre elektrik, kimist, mekanik etj;

- rezultojnë dy pozicione pune të njëjta për nga kuptimi, që i përkasin grupeve të ndryshme dhe niveleve të ndryshme të pagave. Konkretisht, në grupin 3 të pagave, është përcaktuar pozicioni i punës “Supervizor” dhe në grupin 6 është përcaktuar pozicioni i punës “Mbikëqyrës” me të njëjtin kuptim, por me pagë grupi të ndryshme.

- ekziston një numër i konsiderueshëm punonjësish në pozicionin e “Lexuesit”, “Operator terreni” dhe “Arkëtar”, të cilët nuk janë përfshirë në grupet e pagave.

- Referuar Rregullores së Brendshme të UKKO, të miratuar më datë 17.04.2003, me ndryshime në datat 08.04.2005 dhe 05.02.2008, përshkrimi i pozicioneve të punës, nuk është në përputhje me strukturën e pozicioneve të punës dhe nivelin e pagave të miratuar me vendimin nr. 2 datë 22.11.2011 të KM, si dhe strukturat organizative respektive për vitet 2015-2017.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 41-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**7.1. Rekomandim:** Nga Administratori i Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, të merren masa të menjëhershme për hartimin dhe miratimin e Rregullores “Mbi funksionimin e brendshëm të UKKO”, e cila të jetë në përputhje me strukturën dhe pozicionet e punës të miratuara nga KA, si dhe të përshkruhen qartë pozicionet e vendeve të punës, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, rregullat e etikës etj.

**Menjëherë**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i disa “Kontratave individuale të punës” të lidhura midis punëmarrësit dhe punëdhënësit, si dhe i listë-pagesave të pagave të punonjësve ka rezultuar se, në këto dokumente nuk përcaktohen të gjithë elementet përbërës të pagës.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 41-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**8.1. Rekomandimi:** Të merren masa për plotësimin e “Kontratës individuale të punës”, me të gjithë elementet e pagës të parashikuar në aktet ligjore.

**Menjëherë**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve të personelit ka rezultuar se, të dhënat dhe dokumentacioni i personelit, nuk është organizuar në mënyrën e duhur, pasi mungon dosja individuale e personelit me indeksin përkatës sipas regjistrimit të personelit, inventari i dosjes etj.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 41-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**9.1. Rekomandimi:** Nga Zyra e Burimeve Njerëzore, të merren masa për plotësimin e “Dosjeve të personelit”, inventarizimin dhe indeksimin e tyre, sipas numrit përkatës në regjistrin e personelit.

**Brenda 30 ditësh**

**10. Gjetje nga auditimi:** Është konstatuar pagesa e disa punonjësve, të cilësuar në listë-pagesa “Përgjegjës grupi” me pagën e grupit 6, që i përket pozicionit të punës “Mbikëqyrës”. Nga ana e zyrës së Financës, ky veprim shpjegohet pasi këto punonjës kanë punuar si “Përgjegjës grupesh”. Gjithashtu, nuk ekziston asnjë urdhër i Drejtorit ku të jetë i përcaktuar pozicioni i përgjegjësit të grupit, gjë që e bën të pajustificueshme dhe të pambështetur pagesën e këtyre punonjësve me pagën e grupit 6.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 41-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**10.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Financës, të merren masa për eliminimin e të gjitha rasteve të pagesave të punonjësve, për pozicione pune të pa miratuara, në strukturë dhe të pa përfshira në grupet e punës dhe nivelit të pagave respektive.

**Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:** Ujësjetllës Kanalizimeve Korçë SHA, mbajtjen e kontabilitetit dhe paraqitjen e pasqyrave financiare e ka kryer sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, ndërkohë që sipas Vendimit nr. 63, dat 27.01.2016, “P r riorganizimin e operator ve q ofrojn shërbimin e furnizimit me uj t pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave t ndotura”, neni 26, “Inventari, llogaritë vjetore”, kërkohet zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr. 51-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**11.1. Rekomandimi:** Shoqëria duhet të marrë masa që për periudhat ushtrimore në vazhdim mbajtjen e kontabilitetit dhe paraqitjen e pasqyrave financiare, ta kryejë mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

**Menjëherë**

**12. Gjetje nga auditimi:** Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, nuk ka kryer zhvlerësimin e zërit kërkesa të arkëtueshme, i cili mbart vlera nga vitet 2008-2012, duke vepruar kështu, në kundërshtim me SKK3, “Instrumentet Financiare” (Standardet e deklaruara se janë zbatuar nga Shoqëria).

*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr. 51-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**12.1. Rekomandim:** Shoqëria duhet të marrë masa për kryerjen e zhvlerësimit të zërit të kërkesave të arkëtueshme, me qëllim që të sigurohet një pasqyrim i vërtetë e i besueshëm i pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të parasë së njesisë ekonomike.

**Menjëherë**

**13. Gjetje nga auditimi:** Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, në z rin aktive afatgjata, ka klasifikuar vler n 54,473,992 lek , e cila p rfaq son detyrimin e mbetur të kontributit për

periudhën kohore 2009-2015, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (Ish-Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit)<sup>1</sup> kundrejt Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA. Detyrimi që Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ka kundrejt Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, është zbritur nga detyrimi që Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA ka kundrejt kredithënësit, duke u ulur nga viti në vit këtë detyrim, i cili në fakt është paguar nga Ministria e Financave (si garant). Ky kompensim sht kryer pa asnj akt-marr veshje si me Ministrin e Transportit dhe Infrastrukturës si dhe me Ministrin e Financave dhe Ekonomisë. Ky veprim i njëanshëm dhe i gabuar ka sjellë që kontabilizimi për interesat e kredive, të mos regjistrohet si shpenzim të periudhës, por është kompensuar në llogarinë e detyrimeve, që Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (Ish-Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit) ka kundrejt Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA

*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr. 51-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**13.1. Rekomandim:** Shoqëria duhet të marrë masa për ndërprerjen e një praktike të tillë, si dhe kryejë kontabilizimin e detyrimeve dhe të drejtave të konstatuara, në periudhat në vazhdim sipas standardeve kontabël.

**Menjëherë**

**14. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria nuk ka pasqyruar efektin e ndryshimeve të kursit të këmbimit në fund vitit, në kundërshtim me standardin kombëtar të kontabilitetit nr. 12, i ndryshuar, efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit, pika nr. 13, “Raportimi në fund të periudhave raportuese të mëpasshme”.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr. 51-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**14.1. Rekomandim:** Shoqëria duhet të marrë masa për korrigjimin e zërave monetarë, ku në fund të periudhës ushtrimore të reflektohen diferencat nga kursi i këmbimit, me qëllim pasqyrimin real të situatës financiare të shoqërisë.

**Menjëherë**

**15. Gjetje nga auditimi:** Në llogaritjen e amortizimit për periudhën 2015, gabimisht vlera e amortizimit për aktivin “impianti fotovoltaik” sht vlerësuar dy herë, duke rezultuar me shumën vlerën 12,103,875 lek. Ky veprim ka ndikuar në uljen e rezultatit të shoqërisë.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr. 51-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**15.1. Rekomandim:** Shoqëria duhet të marrë masa për korrigjimin e gabimit të kryer në vitin 2015 duke kryer veprimet përkatëse, me qëllim eliminimin e veprimeve të cilat kanë ndikuar dhe ndikojnë në rezultatin financiar të saj, si dhe në një pasqyrim jo real të situatës financiare të shoqërisë.

**Menjëherë**

**16. Gjetje nga auditimi:** Në vitin 2014 shoqëria ka finalizuar investimin në matësat e ujit me vlerën 369,969,600 lek. Ky investim sht kaluar nga departamenti i financës në grupin e instalimeve teknike të ujësjetllës dhe sht amortizuar me normën 1%. Kjo normë sht e pabazuar në të dhënat teknike mbi jetëgjatësinë e aktivitetit dhe në kundërshtim me modelin e

<sup>1</sup> Marrëveshja e Projektit dhe Financimit” midis Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (ish MPPTT), në zbatim të Marrëveshjes me KfW Korça IV-2008.

rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve SHA", ku përcaktohet se jetëgjatësia e një ujëmatësi është 7-10 vjet. Efekti në llogaritjen e amortizimit sht vlera 33,297,264 lek , të pa p r fshira n shpenzimet e periudh s vitit 2015 dhe 2016. Gjithashtu, konstatohet se shoqëria nuk ka përdorur të njëjtën politikë kontabël në caktimin e grupeve p r amortizim t aseteve dhe UKKO ka përdorur norma të pa miratuara nga ortaku.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr. 51-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**16.1. Rekomandim:** Shoqëria duhet të marrë masa për korrigjimin e gabimit të kryer në periudhat 2015 dhe më pas, duke i reflektuar në rezultatin e shoqërisë, me qëllim paraqitjen reale të situatës financiare të saj.

**Menjëherë**

**17. Gjetje nga auditimi:** Në Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, në fund t vitit 2014 ka përfunduar investimi për instalimin e mat save elektronik Wireless, si dhe sht kontabilizuar vlera 473,172,387 lek , e cila p rb het nga vlera 369,969,600 lek mat sa dhe pjesa tjet r nd rtesa, pajisje informatike dhe mobilje e pajisje zyre.

- Duke u nisur nga fakti q , mat sit e instaluar nga investimet e kryera n periudh n 2003-2005 (kredit dhe grantet e marra), nuk janë evidentuar n nj klas t veçant , por janë trajtuar si pjes e instalimeve t rjetit, ka b r t pamundur llogaritjen e sakt t amortizimit n vite dhe vler n e mbetur kontab l.

- Gjithashtu, shoqëria nuk ka llogaritur vler n e mbetur t “mat save t nxjerr jasht përdorimit” dhe nuk ka kryer vler sime p r vler n kontabël të mbetur, me qëllim kryerjen e korrigjimeve p rkat se n z rin e aktiveve.

- Norma e amortizimit p r grupin ku jan futur mat sat sht 1%, nd rkoh q mat sat e ujit kan nj jet gjat si nga 7-10 vjet.

- Vlera e mbetur kontab l e mat save t ujit, t z vend suar sht rreth 332,972,640 lek , vler kjo q duhet t zbritet si shpenzim i periudhës kur sht kryer investimi n vitin 2014.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr. 51-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**17.1. Rekomandime:** Shoqëria duhet të marrë masa për korrigjimin e gabimit të kryer në vitin 2015, duke kryer veprimet përkatëse lidhur me rishikimin e normës së amortizimit, rivlerësimin të tij, si dhe regjistrimit të drejtë në kontabilitet, me qëllim pasqyrimin e një situatë financiare reale të shoqërisë.

**Menjëherë**

**18. Gjetje nga auditimi:** Në llogaritjen e detyrimeve p r sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, në pagën bruto nga departamenti i financës nuk janë p r fshir dhe shpërblyerimet e p r rshme p r ushqim. P r vitin 2015 vlera e pa shtuar n pagën bruto sht 6,111,757 lekë dhe p r vitin 2016 vlera sht 5,074,792 lekë, në kundërshtim me Vendimin nr. 77, dat 28.01.2015, “P r kontributet e detyrueshme dhe p rfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimit i kujdesit shëndetësor”, pjesa II. paga për efekt të llogaritjes së kontributeve.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr. 51-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*



**18.1. Rekomandime:** Shoqëria duhet të marrë masa për korrigjimin e gabimit të kryer në periudhat përkatëse ushtrimore dhe në vazhdim, me qëllim përlllogaritjen e saktë bazës mbi të cilën përlllogariten sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe për rrjedhojë dhe të vlerës së tyre.

**Menjëherë**

**19. Gjetje nga auditimi:** Ujësjiellës Kanalizime Korçë SHA, si rezultat i moszbatimit të ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), që ka deklaruar se ka zbatuar gjatë hartimit të pasqyrave financiare, si dhe Vendimit nr. 1304, i ndryshuar, datë 11.12.2009 për miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjiellës-kanalizimeve SHA", nuk ka p r fshir shpenzimet e sipas periudhave përkatëse, duke sjellë q rezultat i shoq ris p r periudhat 2015 dhe 2016 t mos jet i sakt dhe i besuesh m. Nga kryerja e korrigjimeve t m sip rme, për shpenzimet e pa p r fshira, rezulton që viti ushtrimor 2015, të rezultojë me humbje në vlerën 55,504,000 lekë dhe viti ushtrimor 2016, të rezultojë me humbje në vler n 74,987,000 lek .

*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr. 51-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**19.1. Rekomandim:** Të merren masa të menjëhershme nga Këshilli i Administrimit, Administratori, Drejtori i Departamentit Tregtar dhe nga Zyra e Financës, për shqyrtimin e kontabilizimeve të gabuara, korrigjimin e tyre dhe të efektit në rezultatin financiar të Shoqërisë për vitet 2015 dhe 2016, reflektimin e tyre në pasqyrat financiare të vitit 2018, si dhe paraqitjen e tyre në Asamblenë e Përgjithshme për miratim.

**Menjëherë**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga shoqëria prej datës 31.12.2017, p r kredin me vler 3,110,649 euro dhe prej datës 31.12.2016 p r kredin 6,136,259 euro, nuk është kryer likuidimi i detyrimeve për principalin dhe interesat e kredive. Vlera e principalit n shumën 9,359,072 euro dhe interesave n shumën 2,487,114 euro, sht paguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomis , në cilësinë e garantit të kredive. Shoqëria gjatë kësaj periudhe edhe pse ka rezultuar me një situat financiare t cash flow-t pozitive, pasi q nga viti 2012 ka pasur n depozita bankare vlerat nga 430,000,000 lek deri n 320,000,000 lek , nuk ka paguar detyrimet ndaj kredive. Nga t dh nat q disponon Ministria e Financave, kosto p r sigurimin e likuiditetit nga viti 2012 deri n vitin 2017, nga ankandet e emetimit t letrave me vler , ka l vizur nga 6.5 % n 2.4 %. Duke marr vlerat mesatare p r llogaritje, Ministria e Financave ka pasur një kosto prej 512,000 euro p r pagesat e principaleve dhe interesave t kredive t Uj sjell s Kanalizime SHA Korç , t papaguara nga viti 2012 deri m vitin 2017.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr. 51-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**20.1. Rekomandim:** Në kushtet që Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Korçë SHA ka qenë dhe është në kushte të favorshme të cash flow-t, të marrë masa të menjëhershme për likuidimin e detyrimeve të lindura nga marrëveshjet e kredive.

**Menjëherë**

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga Ujësjiellës Kanalizime Korçë SHA, regjistri i aktiveve nuk është i plotë, pasi:

- nuk ka certifikata pron sie p r një pjes t madhe t truallit q ka n z rin troje.

- në zbatim të shpenzimeve materiale të periudhës janë klasifikuar pajisje elektrike, hidraulike që kanë jetëgjatësi mbi një vit dhe tejkalojnë vlerën 10,000 lekë. Në këto zëra u konstatuan matësa, saraçineska, pajisje elektrike me vlerë mbi 10,000 lekë, të klasifikuar si shpenzime të periudhës këto pajisje elektrike ose teknologjike nuk regjistrohen në regjistrin e aktiveve të shoqërisë.

- në lidhje me aktivet troje, ndërtesa, godina, stacione pompimi, pajisje teknologjike, elektrike, hidraulike që përkasin rrjetet e ujësjellës dhe kanalizimeve është kryer inventarizimi fizik i elementeve të bazuar në informacione, lista të marra nga zyra teknike e shoqërisë të cilat janë në sasi sipas emërtimeve dhe pa vlerë kontabël.

- procesi i inventarizimit të aktiveve afatgjata, toka, terrene, ndërtesa, depo, puse, rrjete ujësjellës, rrjete kanalizimi, makineri, pajisje pune, materiale për vitin 2015, 2016 dhe 2017 nuk është kryer në përputhje me procedurat.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr. 69-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**21.1.Rekomandim:** Administratori i Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA të marrë masa për fillimin e procedurave për pajisjen me certifikata pronësie të zërit “truall”, për evidentimin e saktë të aktiveve, si dhe plotësimin e Regjistrit të Aktiveve.

**Menjëherë**

**22. Gjetje nga çuditmi:** Në Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, nuk ka mbaruar ende inventarizimi dhe marrja në dorëzim e aseteve të ish “Ujësjellës-Kanalizime” që kanë kaluar nën administrimin e “UKKO” SHA Grupi i punës për verifikimin e gjendjes në terren në zonën e re të shërbimit në zbatim të urdhrit nr. 2015/19, datë 16.12.2015, ka paraqitur më datë 21.06.2016 raportin: “Zgjerimi i zonës së shërbimit, ujësjellës kanalizime në përshtatje të reformës së re territoriale”, i cili është më shumë përshkruar për gjendjen e ujësjellës-kanalizimeve në zonat që i shtohen UKKO Sha, se sa identifikues dhe inventarizues. Mungon informacioni për ujësjellës-kanalizimet për 30 fshatra (nga 63 gjithsej).

*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr. 69-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**22.1. Rekomandim:** Nga Administratori i UKKO, të merren masa të menjëhershme për ngritjen e Grupeve të Inventarizimit, për kryerjen e inventarizimeve, si dhe marrjen në dorëzim të çdo aseti të ish UK Korçë/Fshat, të cilat sipas reformës administrative dhe ndarjes së re territoriale i janë transferuar UK, Bashkia Korçë.

**Menjëherë**

**23. Gjetje nga auditimi:** Gjatë periudhës objekt auditimi u konstatua se nuk ka një planifikim të saktë të numrit dhe nevojave të prokurimeve me vlerë të vogël, pasi shumica e prokurimeve me vlerë të vogël të kryera nga UKKO SHA, nuk janë në regjistrin e parashikimeve në fillim viti, por janë realizuar me shtesa në regjistrin e prokurimeve të cilat i janë dërguar APP-së.

- Përkatësisht për vitin 2015, në datën 18.02.2015 me shkresën nr 12/1 i është dërguar APP regjistri vjetor i parashikimit të prokurimeve publike me vlerë të vogël për vitin 2015. Janë dërguar 4 shtesa regjistri prokurimesh përgjatë vitit. Në datën 06.01.2016 i është dërguar APP shkresa me nr. 12/2, mbi regjistrin përmbledhës i realizimit të prokurimeve publike me vlerë të vogël për vitin 2015.

- Për vitin 2016, në datën 06.01.2016 me shkresën nr. 5 i është dërguar APP regjistri vjetor i parashikimit të prokurimeve publike me vlerë të vogël për vitin 2016. Janë dërguar 19 shtesa

regjistri prokurimesh përgjatë vitit. Në datën 16.01.2017 i është dërguar APP shkresa me nr. 21, mbi regjistrin përmbledhës i realizimit të prokurimeve publike me vlerë të vogël për vitin 2016. - Për vitin 2017, në datën 25.01.2017 me shkresën nr. 21/1 i është dërguar APP regjistri vjetor i parashikimit të prokurimeve publike me vlerë të vogël për vitin 2017. Janë dërguar 8 shtesa regjistri prokurimesh përgjatë vitit. Në datën 12.01.2018 i është dërguar APP shkresa me nr. 24, mbi regjistrin përmbledhës i realizimit të prokurimeve publike me vlerë të vogël për vitin 2017. *Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe nr. 149-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**23.1. Rekomandim:** Nga Administratori i Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, të merren masa të menjëhershme që në të ardhmen të bëhet një studim më i plotë i nevojave për mallra, shërbime, e punë në vlerë të vogël, që në fillim të periudhave ushtrimore me qëllim përfshirjen e tyre në regjistrin e parashikimeve vjetore të fillim vitit.

**Menjëherë**

**24. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u evidentua se, të gjitha blerjet e biletave të avionit, për udhëtim jashtë vendit, janë kryer pa procedura prokurimi dhe pa urdhër nga ana e punësi zbatues, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe nr. 149-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**24.1. Rekomandim:** AK të marrë masa të menjëhershme për ndërprerjen e kësaj praktike dhe të zhvillojë procedurat e prokurimit publik për blerjen e biletave (të avionit) për udhëtim jashtë vendit.

**Menjëherë**

**25. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi rregullshmërinë e shpenzimeve të kryera për udhëtimet e dieta jashtë shtetit, u konstatua se: në 7 raste shërbimesh jashtë vendit, në vitin 2015, me vlerë 392,000 lek; në 7 raste shërbimesh jashtë vendit, në vitin 2016, me vlerë 1,032,000 lek; si dhe në 9 raste shërbimesh jashtë vendit, në vitin 2017, me vlerë 1,347,000 lek, në autorizimet e lëshuara nga administratori i Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, mbi miratimin e shërbimit dhe personave që do të përfaqësojnë Shoqërinë në aktivitetet përkatëse, nuk ishte argumentuar mirësisht e aktivitetit për shoqërimin, lidhja e aktivitetit me pozicionin e punësisit dhe përdorimi me efektivitet dhe efikasitet të burimeve të shoqërisë. *Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe nr. 153-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**25.1. Rekomandime:** Nga administratori i Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, të merren masa të menjëhershme për ndërprerjen e praktikave për dërgimin e punonjësve me shërbim jashtë shtetit, jo në përputhje me kërkesat e pozicionit të punës, si dhe pa argumentuar rëndësinë e kryerjes së shërbimit referuar dobisë që do të sjellin shoqërisë.

**Menjëherë**

**26. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se në Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, nuk ka funksionuar në mënyrën e duhur Sistemi i Kontrollit të Brendshëm, me komponentët e tij. Mungon Strategjia e Riskut dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik, si dhe përsa i përket menaxhimit të riskut, nga ana e Ujësjellës Kanalizime Korçë, nuk është hartuar një regjistër risku në nivel njësie, për rrjedhojë nuk ka një monitorim dhe rishikim të tij gjatë vitit. *Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe nr. 161-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**26.1. Rekomandim:** Administratori i Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, të marrë masa për hartimin e Strategjisë së Riskut, ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik, si dhe për hartimin e Regjistrisë të Riskut në nivel shoqërie, ku të evidentohen risqet, strukturat përgjegjëse, afatet dhe aktivitetet e kontrollit shtesë për minimizimin e tyre.

**Menjëherë**

**27. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se në përgjithësi për aktivitetet dhe operacionet kryesore ka procedura të shkruara, por aktualisht nuk ka një manual të shkruar për përdorimin dhe ruajtjen e sistemeve dhe programeve IT nga stafi, si dhe për mënyrën e komunikimit brenda dhe jashtë njësisë.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe nr. 161-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**27.1. Rekomandim:** Administratori i Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, të marrë masa për hartimin e një manuali/udhëzuesi mbi përdorimin dhe ruajtjen e sistemeve dhe programeve IT, nga stafi, si dhe mënyrën e komunikimit brenda dhe jashtë njësisë.

**Menjëherë**

**28. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se Urdhri i prokurimit, si dhe Urdhri për përgatitjen e specifikimeve teknike kanë të njëjtën datë. Në urdhrin e prokurimit publik kemi miratim të fondit limit, ç'ka tregon se nuk janë marrë për bazë specifikimet teknike, para përlogaritjes së tij, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, si dhe udhëzuesit e Agjencisë së Prokurimit Publik.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe nr. 77-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**28.1. Rekomandim:** Titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të deritanishme, duke ndarë fazën e përlogaritjes së fondit limit, sipas objektit të prokurimit, pjesë e regjistrisë të parashikimit të prokurimeve, me fazën e kryerjes së procedurës së prokurimit gjatë vitit, ku përcaktimi të vlerës limit të kontratës duhet t'i paraprijë përcaktimi i specifikimeve teknike, të argumentuara dhe dokumentuara nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, apo komisionet e ngritura për këtë qëllim, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor.

**Menjëherë**

## **B.I MASA SHPËBLIM DËMI:**

Nga Administratori i Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **11,067,965 lekë**, përfituar më tepër, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të Kontratave me objekt "Ruajtja e objekteve të UKKO Sha, me punonjës shërbimi dhe sistem alarmi", për periudhën 01.03.2015-31.12.2015, me vlerë kontrate në shumën 12,387,020 lekë, për periudhën 01.03.2016-01.03.2017 me vlerë kontrate në shumën 12,764,112 lekë dhe për periudhën 01.03.2017-28.02.2018 me vlerë kontrate në shumën 14,670,000 lekë, u konstatua se, në Stacionin e pompave Turan (SPT), në impiantin e trajtimit të ujërave të përdorura (IUTP), në zyrat e administratës, në Depon e ujit nr. 3 dhe në Depon e ujit nr. 1, sipas dokumentacionit të marrjes/dorëzimit të vendrojes, kryenin shërbimin e

ruajtjes së objektit 3 roje, si dhe nuk disponohej asnjë dokumentacion për të faktuar mënyrën e zbatimit të këtyre kontratave për periudhën objekt auditimi, vitet 2015, 2016 dhe 2017. Gjithashtu rezultoi se, as në Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, nuk disponohej asnjë dokumentacion ku të vërtetohej realizimi i këtij shërbimi, sipas kushteve të përcaktuara në kontratat respektive.

Referuar vlerave të kontratave, numri i rojeve për një vendroje duhej të ishte 4.78 roje/vendroje, ndërkohë që kryejnë shërbimin 3 roje/vendroje, ose 1.78 roje më pak. Pagesa e përfituar nga subjekti kontraktues, për 1.78 roje për vendroje, përbën dëm ekonomik. Konkretisht për periudhën 01.03.2015-31.12.2015 në shumën 3,104,389 lekë, për periudhën 01.03.2016-01.03.2017 në shumën 3,687,906 lekë dhe për periudhën 01.03.2017-28.02.2018 në shumën në vlerën 3,651,393 lekë. Në total vlera e dëmit ekonomik është 10,443,688 lekë.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe nr. 77-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1. Rekomandim:** Administratori i Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, të marrë masa të menjëhershme, për ndjekjen e të gjitha rrugëve ligjore, për kthimin nga ana e Kontraktorit Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “A” shpk dhe “B” shpk, të shumës së përfituar padrejtësisht, **në vlerën 10,443,688 lekë.**

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të Kontratës me objekt “Ruajtja e objekteve të UKKO Sha, me punonjës shërbimi dhe sistem alarmi”, për periudhën 01.01.2015-28.02.2015, realizuar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “A” shpk, “B” shpk dhe “C” shpk, u konstatua se, në Stacionin e pompave Turan (SPT), në impiantin e trajtimit të ujërave të përdorura (IUTP), në zyrat e administratës, në Depon e ujit nr. 3 dhe në Depon e ujit nr. 1, sipas dokumentacionit të marrjes/dorëzimit të vendrojes, kryenin shërbimin e ruajtjes së objektit 3 roje, si dhe nuk disponohej asnjë dokumentacion për të faktuar mënyrën e zbatimit të këtyre kontratave për periudhën 01.01.2015-28.02.2015. Gjithashtu rezultoi se, as në Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, nuk disponohej asnjë dokumentacion ku të vërtetohej realizimi i këtij shërbimi, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Referuar vlerës limit të kontratës, numri i rojeve për një vendroje duhej të ishte 4.78 roje/vendroje, ndërkohë që kryejnë shërbimin 3 roje/vendroje, ose 1.78 roje më pak. Pagesa e përfituar nga subjekti kontraktues, për 1.78 roje për vendroje, që në total është në shumën 424,431 lekë përbën dëm ekonomik.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe nr. 77-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**2.1. Rekomandime:** Administratori i Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, të marrë masa të menjëhershme, për ndjekjen e të gjitha rrugëve ligjore, për kthimin nga ana e Kontraktorit Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “A” shpk, “B” shpk dhe “C” shpk, të shumës së përfituar padrejtësisht, **në vlerën 424,431 lekë.**

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në pagesat e kryera me bankë për udhëtime jashtë vendit, në tre raste, **për vlerën 135,639 lekë**, u konstatuan pagesa për aktivitete kulturore, si dhe pagesa për ditë jo në përputhje me ditët e aktivitetit.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe nr. 170-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**3.1. Rekomandime:** Administratori i UKKO, të marrë masa për nxjerrjen e urdhër zhdëmtimeve për kthimin e vlerave të mësipërme të përfituar padrejtësisht nga përfituesit, A.I., për shumat 663 Euro dhe 115 Usd; S.K., për vlerën 85 Euro dhe z. P. T., për vlerën 175 Euro.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Blerje Gazoil” 2016, ka rezultuar se në përlogaritjen e vlerës së karburantit (Gazoil D1) është marrë gabim kursi i këmbimit Usd/lekë, i cili më datë 17.03.2016 është 1USD= 122.20 lekë (dhe jo 124.52 lekë), gjë e cila ka sjellë një diferencë në vlerën 29,666 lekë, e cila është përfituar padrejtësisht nga subjekti “E” shpk.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe nr. 170-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**4.1. Rekomandim:** Administratori i Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, të marrë masa të menjëhershme, për ndjekjen e të gjitha rrugëve ligjore, për kthimin nga ana e Kontraktorit “E” shpk, të shumës së përfituar padrejtësisht, **në vlerën 29,666 lekë.**

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjetllës” nga subjekti “D” shpk, ka rezultuar se nga Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, nuk janë mbajtur në masën e duhur penaltitetet, si rezultat i moszbatimit në afat të kontratës, për vlerën 34,541 lekë, e cila është përfituar padrejtësisht nga subjekti “D” shpk.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe nr. 170-178 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**5.1. Rekomandim:** Administratori i Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, të marrë masa të menjëhershme, për ndjekjen e të gjitha rrugëve ligjore, për kthimin nga ana e Kontraktorit “D” shpk, të shumës së përfituar padrejtësisht, **në vlerën 34,541 lekë.**

**Menjëherë**

## **B.II MASA PR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga ana e zyrës së financës, nuk është bërë derdhja e detyrimit, në favor të Ish të dënuarve dhe përndjekurve politikë për periudhën objekt auditimi, për vlerën 2,285,600 lekë, respektivisht: për vitin 2015 në shumën 420,600 lekë; për vitin 2016 në shumën 770,000 lekë dhe për vitin 2017 në shumën 795,000 lekë.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 41-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1. Rekomandimi:** Administratori i Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, të marrë masa të menjëhershme për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në shumën **2,285,600 lekë**, ndaj Ish të dënuarve dhe përndjekurve politikë, si dhe derdhjen e këtij kontributi edhe në vazhdimësi, në kohën e duhur.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se, në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje gazoil” viti 2016, KVO në mënyrë të padrejtë ka skualifikuar OE “F” shpk. AK për vlerësimin e ofertës së OE “F” shpk i është referuar një kriteri i cili nuk është përfshirë në DT. Vlerësimi i ofertuesve nga ana e KVO-së, për kritere të cilat nuk janë kërkuar në DT përbën shkak për skualifikim të padrejtë të tyre. Për sa më sipër rezulton se, KVO ka skualifikuar padrejtësisht OE “F” shpk me ofertë më të ulët se OE i shpallur fitues “E” shpk, me një diferencë në marzhin e fitimit  $(12.5-11.8)=0.7\%$ , ç’ka përbën dëm ekonomik.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe nr. 77-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**2.1. Rekomandim:** Titullari i Autoriteti Kontraktor “Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, të marrë masa, si për përlllogaritjen e dëmit ekonomik si diferencë në marzhin e fitimit prej 0.7 %, gjatë zbatimit të kontratës, po ashtu edhe për rikuperimin e tij nga personat përgjegjës.

**Menjëherë**

### **B.III MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË TË ARDHURAT E SHOQËRISË.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në zbatim të Marrëveshjes së Projektit të Kanalizimeve Korça IV-2008, midis Bankës Gjermane KfW dhe Qeverisë Shqiptare, përfaqësuar nga Ministria e Financave, është lidhur “Marrëveshja e Projektit dhe Financimit” midis Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (ish MPPTT) dhe Bashkisë Korçë me Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA. Në zbatim të kësaj marrëveshje, Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, nuk ka llogaritur detyrimet e Bashkisë Korçë, të cilat sipas marrëveshjes rezultojnë në shumën 890,000 Euro, përkatësisht; p r vitin 2008 në shumën 50,000 euro, p r vitin 2009 në shumën 60,000 euro, p r vitin 2010 në shumën 80,000 euro dhe nga viti 2011 deri m 2017 me 100,000 euro n vit, veprime në kundërshtim me standardet e kontabilitetit.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe nr. 51-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1. Rekomandim:** Asambleja e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, Këshilli i Administrimit dhe Administratori, duhet të marrin në analizë këtë fakt, si dhe të ndërmarrin veprime konkrete për arkëtimin e shumës prej **890,000 Euro** që Bashkia Korçë ka ndaj UKKO, sipas marrëveshjes, si dhe të bëhet pasqyrimi i tyre në kontabilitet.

**Menjëherë**

### **C. MASA DISIPLINORE:**

**C.I.** Për shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i propozoj Asamblesë së Përgjithshme, që bazuar në Statutin e Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, nenin 15 “Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit”, të marrë masën **“Largim nga puna”**;

**1. Për Z. P.T,** me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA dhe anëtar i Këshillit Administrativ të Shoqërisë, për shkeljet e mëposhtme:

- Në 5 raste, rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, pa shkaqe objektive dhe në mënyrë të paargumentuar, nuk kanë gjetur zbatim nga Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA.

- Mungesë e Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të UKKO, në përputhje me ndryshimet strukturore të saj;
- Mosfunksionim i sistemit të kontrollit të brendshëm, reflektuar në mungesën e Strategjisë së Riskut, mungesën e Grupit të Menaxhimit Strategjik, mungesën e Regjistrisë së Riskut, mungesën e Pyetësorit të Vetëvlerësimit, si dhe Gjurmës së Auditimit dhe Hartës së Proceseve, për disa aktivitete kontrolli;
- Mos zbatimi i ligjit nr. 7928, dat 27.04.1995, “P r tatimet mbi vler n e shtuar”, i ndryshuar dhe udh zimit nr. 17, dat 13.05.2008, “P r tatimin mbi vler n e shtuar”, i ndryshuar, pika 5.1, në hartimin e kontratës të blerjes së elementëve fotovoltaikë, nga administratori, shoqëria sht ngarkuar me barr n e pages s s vler s s Tvsh-s , p r 18 muaj n vend q ta paguante p r periudh n 72 mujore, duke i kaluar shoq ris F.M.O. sh.p.k., likuiditete n fillim t periudh s s amortizimit t pagesave t investimit nd rkoh q ka paguar dhe interesin 3.7 % n vit p r vler n debitore;
- Në lidhje me shpenzime për udhëtime e dieta, me vlerën 2,771,000 lek , n autorizimet e l shuara nga administratori z. Petrit Tare nuk ishte argumentuar mir r nd sia e aktivitetit p r shoq rin , lidhja e aktivitetit me pozicionin e pun s si dhe p rdorimi me efektivitet dhe efiçenc t burimeve t shoq ris ;

**Menjëherë**

**C.II.** Për shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, sipas personave përgjegjës i propozoj Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit të Administrimit si dhe Administratorit të Shoqërisë, që mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar Statutin e Ujësjellës Kanalizime Korçë SHA, si dhe në Kontratën Individuale të Punës, nenin 31 “Shkeljet disiplinore” dhe nenin 32 “Masat disiplinore”, të marrë masat disiplinore si më poshtë:

**1. Për Znj. E.P.**, me detyrë Drejtore Tregtare, si dhe në cilësinë e Titullarit të Autorizuar të Autoritetit Kontraktor, propozohet masa disiplinore **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”**, bazuar në nenin 32, germa “b”, për shkeljet e mëposhtme:

- Shkelje të nenit 56 të LPP-së, mbi nxjerrjen e urdhrave për ngritjen e komisioneve përkatëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik;
- Për blerjen e biletave për udhëtime jashtë vendit, pa procedurë, në kundërshtim me LPP, Rregullat e prokurimit publik, si dhe në kundërshtim me ligjin për "Menaxhimin financiar dhe kontrollin";
- Mosfunksionim i sistemit të kontrollit të brendshëm, reflektuar në mungesën e Strategjisë së Riskut, mungesën e Grupit të Menaxhimit Strategjik, mungesën e Regjistrisë së Riskut, mungesën e Pyetësorit të Vetëvlerësimit, si dhe gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve, për disa aktivitete kontrolli.

**Menjëherë**

**2. Për Znj. F.F.**, me detyrë Menaxhere e Zyrës së Kontabilitet-Financës, masa disiplinore **“Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët”**, bazuar në nenin 32, germa “e”, për shkeljet e mëposhtme:

-Mos zbatimi i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit lidhur me kompensimet e detyrimeve të shoqërisë si dhe mos paraqitjen e shpenzimeve për interesa në rezultatin financiar të periudhës ushtrimore 2016, mos llogaritja e detyrimeve të Bashkisë Korçë, mos llogaritja e saktë e



shpenzimeve të amortizimit, mos kryerja e veprimeve kontabël lidhur me vlerën e mbetur të matësave të zëvendësuar, mos pasqyrimi i efekteve të ndryshimeve të kursit të këmbimit të fund vitit për zërat monetarë të pozicionit financiar. Veprime të gabuara kontabël, të cilat kanë sjellë ndryshim të rezultatit financiar të Shoqërisë për vitin 2015 dhe 2016, konkretisht në Vitin 2015 në vlerën 55,504,000 lekë me humbje dhe në Vitin 2016 në vlerën 74,987,000 lekë me humbje.

**Menjëherë**

**C.III.** Këshilli i Administrimit dhe Administratori i Shoqërisë, të marrin në analizë shkeljet dhe të nxjerrin përgjegjësitë e strukturave, të cilat kanë realizuar procedurat e prokurimit publik, në Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA gjatë periudhës objekt auditimi (2015-2017), të trajtuara dhe cilësuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit faqe 77-149.

#### **D. MASA ADMINISTRARIVE:**

I rekomandoj Agjencisë së Prokurimit Publik që, mbështetur në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenet 4, 13, germa “i” dhe nenin 72, si dhe në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar Kreu XI “Sanksionet administrative dhe masat disiplinore”, neni 79 “Sanksionet administrative”, për moszbatim të kuadrit rregullator të prokurimeve publike, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, në periudhën 2015-2017, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 77-149, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të vendosë gjoba ndaj personave përgjegjës si më poshtë,

#### **Për anëtarët e grupit për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës:**

1. Zj. A.I.
2. Z. A.M.
3. Z. M.T.
4. Z. V.P.
5. Zj. F.F.
6. Z. P.Q.
7. Z. A.K.
8. Z. P.K.
9. Z. A.A.
10. Zj. V.C.
11. Z. J.Q.

Në cilësinë e specialistëve të fushave përkatëse të ngarkuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Ujësjetllës Kanalizime Korçë SHA, për përlllogaritjen e nevojave dhe fondit limit, kanë vepruar në kundërshtim me LPP, nenin 28, pika 3 dhe VKM nenin 59, pasi në përlllogaritjen e vlerës limit nuk i janë referuar praktikisht metodave të cilësuar.

**Menjëherë**

#### **Për anëtarët e Njësisë së Prokurimit:**

1. Zj. K.L., në cilësinë e Juristes së NJP
2. Z. M.T.
3. Z. V.P.
4. Z. I.P.
5. Zj. M.S.

Në cilësinë e anëtarëve të NJP-së, por të ngarkuar me urdhër të Titullarit të Autorizuar të Autoritetit Kontraktor edhe për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta për kualifikim, për shkelje të LPP-së, neni 12 “Përgjegjësitë e Autoritetit Kontraktor”, pasi në asnjë prej procedurave të zhvilluara, nuk kanë mbajtur procesverbale për përcaktimin, argumentimin dhe përshkrimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, si dhe për shkelje të LPP-së, nenin 23 “Specifikimet teknike”, pasi nuk ka asnjë gjurmë mbi vlerësimin e specifikimeve dhe vendosjen e kritereve për kualifikim të pasqyruara në shtojcat përkatëse të dokumenteve të tenderit.

**Menjëherë**

**Për anëtarëve të Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave:**

1. Z. I.P.
2. Z. V.P.
3. Z. M.T.
4. Z. P.Q.
5. Zj. V.C.
6. Z. A.A.
7. Z. P.K.

Në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, për shkelje të LPP-së, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pasi në disa prej procedurave të zhvilluara, kanë kualifikuar operatorë ekonomikë, të cilët nuk kishin përmbushur kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Menjëherë**

**Për strukturën Përgjegjëse për Zbatimin e Kontratave:**

1. Z. P.K.
2. Z. A.A.
3. Z. V.P.
4. Zj. F.F.

Në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, për shkelje të LPP-së, neni 77 “Zbatimi i kontratës” pasi nuk kanë bërë dhe dokumentuar sipas kërkesave të ligjit zbatimin e kontratave duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 10,932,326 lekë.

**Menjëherë**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike.

---

**BUJAR LESKAJ**

**KRYETAR**